

**AKT THEMELIMI DHE STATUT**

**I**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Sot më datën 05.10.2020 në përputhje me Ligjin Nr 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët, dhe Shoqëritë Tregtare" ortaku i vetëm i mëposhtëm, zotërues i 100% i kuotave te kapitalit të shoqërisë, me zotësi madhore :

Z. Artur Jakaj lindur në Milot më 06/01/1976 dhe banues në Tiranë me kartë identiteti H60106072T.

**VENDOSI:**

Të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "X" X M-arketing" Shpk duke ju referuar Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare"

**ORTAKU I VETËM**

**ARTUR JAKAJ**

ARTUR JAKAJ  


# **STATUT**

## **I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “X” X M-arketing” shpk**

### **Hyrje**

Sot në datën 05.10.2020 sipas Aktit të themelimit me cilësinë e administratorit po formulojmë këtë statut të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “X” X M-arketing” Shpk në mbështetje të Nenit 230 të ligjit nr 9901 datë 14/04/2008, “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Aktiviteti i shoqërisë do të zhvillohet duke u mbështetur në dispozitat e këtij Statuti.

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Ligjet Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”, i ndryshuar”
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

### **Kreu I**

#### **Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**

#### **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më 01.10.2020 , unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin ““X” X M-arketing” Shpk.

(2) Themeluesi i shoqërisë është Z. Artur Jakaj, i biri i Zef-it dhe i Vjollca, lindur në Milot datë 06/01/1976 dhe banues në Tiranë, me Adresë Rruga “Grigor Cilka”, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID Nr H60106072T, lëshuar në datën 18/12/2018.

**Neni 2:**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Aktivitet në fushën e marketingut në Web. Prodhim dhe studim i shërbimeve të marketingut. Marketing të shërbimeve pa kufizime territoriale, të shërbimeve të komunikimit që rrjedhin nga zvillimi i teknologjive;

Aktivitet në fushën e ofrimit të shërbimeve të ndryshme online;

Aktivitet kërkimor, përzgjedhje, orientim, trajnim dhe aktivitete profesionale trajnimi me sisteme në largësi dhe multimediale;

Aktivitet ne fushën e organizimit të seminarave, takime, konferanca, organizime të përgjithshme dhe aktiviteteve të promovimit të imazhit;

Aktivitet në fushën e tregtisë elektronike edhe për llogari të palëve të treta;

Shoqëria mund të marrë pjesë në cilësinë e ortakut apo të aksionerit në shoqëri të tjera tregtarë me objekt të njëjtë ose të ndryshëm. Në përputhje me legjislacionin Shqiptar, në mënyrë që të arrijë objektin e lartpërmendur, shoqëria mundet gjithashtu: Të kryejë çdo transaksion lidhur me asetat e luajtshme ose pasuritë e paluajtshme, vendosja e pengjeve, hipotekës, barreve si dhe aktivitete te cilat mund të konsiderohen të nevojshme per të arritur aktivitetin e Shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë aktivitete të tjera të cilat nuk ndalohen nga ligji në fuqi, të vlefshme dhe me interes për Shoqërinë, me anë të pajisjes me licencat e nevojshme.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pa përcaktuar. Ajo do të drejtohet nga Administratori, Z. Artur Jakaj i cili është dhe aksioneri i vetëm i shoqërisë. Shoqëria mund të prishet ose të pushojë aktivitetin e saj me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve, në bazë të legjislacionit Shqiptar dhe statutit të shoqërisë.

**Neni 4:**

**Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën Rruga "Abdyl Frashëri", Ndërtesa nr. 8, shkalla A, kat 10, Tiranë.



## Kreu II

### Kapitali

#### Neni 5

##### **Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 Lekë (dhjetë mijë lekë) i ndarë me 1 kuotë me vlerë 10,000 (dhjetë mijë) lekë për kuotë. Pjesëmarria e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Artur Jakaj: Zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 (dhjetë mijë) Lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### Neni 6:

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përsaqësojnë.

#### Neni 7

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**

**Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton edo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përçaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për martjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ccurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 9**

**Mënyra e thirrjes se mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë



vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10**

##### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë votë, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11**

##### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.



## Neni 12

### Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo tëpër fitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuar vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtusi dhc ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorët e shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorët e një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

Artur Jakaj, Rruga "Grigor Cilka"

dhe specimenët e nënshkrimit:



Neni 14

### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:



- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në raste kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 15**

**Përgjegjësitë e Administratorit**



Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hëtit të detyrave të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka bartën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë tërregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivitet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.



Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkeshë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

##### **Viti finanziar-ekspertet**

###### **Neni 16**

###### **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përashtimi, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

###### **Neni 17**

###### **Ekspertert**

Eksperi ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij përrastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperi kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqesë e dorëzojë nëe kohë ortakëve për t'i shqyrta e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Kreu V**

##### **Prishja -riorganizimi i shoqërisë**

###### **Neni 18**

###### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të bëhet në cdo kohë :

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
  - me vendim të Asamblese se Ortakeve;
  - me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtar tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nonit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";



d) me vendim tē gjykatës;

Ne kete rast Ortakët marrin vendim me shkrim nē tē cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit tē shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar nē cdo dokument tē nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri nē likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tē likuidimit nē gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim tē rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për tē caktuar një likuidues.

#### **Neni 19**

#### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund tē ndahet, bashkohet sipas Vednimit tē Mbledhjes së Përgjithshme tē Asamblesë së Ortakëve, nëpërputhje me dispozitat ligjore tē parashikuara nē Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Pëtregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Pëtregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik nē Republikën e Shqiperisë.

#### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarreveshjet që mund tē lindin nē lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund tē lindë midis Shoqërise dhe tē tretëve, do tē jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKET  
E SHIQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**ARTUR JAKAJ**

